




AKADEMIA E STUDIMEVE
ALBANOLOGJIKE
TIRANË

Nr. 387 Prot



INSTITUTI ALBANOLOGJK
PRISHTINË

Nr. 375 Prot



INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE TË SHQIPTARËVE - SHKUP
ИНСТИТУТ ЗА ДУХОВНО И КУЛТУРНО НАСЛЕДСТВО НА АЛБАНИЈАТЕ - СКОПЈЕ
INSTITUTE OF SPIRITUAL AND CULTURAL HERITAGE OF THE ALBANIANS - SHKUP

Nr. 290 Prot

MOMERANDUM BASHKËPUNIMI 2021-2026

NDËRMJET

AKADEMISË SË STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE -
TIRANË,

INSTITUTIT ALBANOLOGJIK - PRISHTINË

DHE

INSTITUTIT TË TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE - SHKUP

Në mbështetje të Ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Marrëveshjes së Bashkëpunimit më datë 23.03.2015, ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës;

Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe institucioneve arsimore të Maqedonisë së Veriut; dhe të udhëhequr nga parimet e mirëkuptimit dhe të respektimit të ndërsjellë, nga dëshira dhe nevoja për zhvillim dhe thellim të bashkëpunimit akademik, të tria institucionet realizojnë këtë marrëveshje për bashkëpunimin në fushën e kërkimit shkencor dhe arsimit të lartë.

Tri institucionet, Akademia e Studimeve Albanologjike - Tiranë, Instituti Albanologjik - Prishtinë dhe Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve - Shkup, do të nxitin bashkëpunimin për kërkimin shkencor, në fushën e albanologjisë, përfshirë edhe shkëmbimin e ekspertëve dhe punonjësve shkencorë, si dhe angazhohen për nisma projektsh të përbashkëta kërkimore-shkencore rajonale dhe ndërkombëtare.

Neni 1

Fusha e veprimit

1. Bashkëpunim për ideimin dhe zhvillimin e projekteve të përbashkëta kërkimore-shkencore dhe arsimore, në interes të përbashkët të tri institucioneve në fushën e albanologjisë.
2. Pjesëmarrje në programet e projektet kërkimore-shkencore dhe arsimore, të miratuara dhe bashkëfinancuara nga institucionet përgjegjëse të palëve, si dhe ato projekte të financuara nga Bashkimi Europian dhe organizma të tjera ndërkombëtare.
3. Shkëmbim të botimeve, periodikëve, revistave e monografive me interes të përbashkët.
4. Zhvillimin e konferencave shkencore, simpoziumeve, seminareve, tribunave të përbashkëta dhe programeve specifike, si edukimi në shkencë etj.
5. Shkëmbim të informacioneve në fushat e kërkim-zhvillimit, që janë në interes të përbashkët.
6. Ideimin dhe realizimin e projekteve shkencore, strukturave të reja të kërkimit me rëndësi kombëtare në bashkëpunim me kompani private, vendase e të huaja.
7. Veprimtari të përbashkëta promovimi dhe publikimi, me qëllim sensibilizimin e qytetarëve, për projekte ndërmjet këtyre tri institucioneve dhe institucioneve të tjera bashkëpunuese.
8. Bashkëpunim në drejtim të procesit të mësimdhënies, kualifikimit shkencor e nismave për stimulimin e kërkuesve të rinj.

9. Botimi i një reviste të përbashkët albanologjike (print dhe digjitale).
10. Përgatitja dhe aftësimi i kuadrove, që si bazë do të kenë njohjet e gjuhëve të lashta: greqisht, latinisht, persisht dhe osmanisht.
11. Botimi dhe ribotimi i teksteve të albanologëve shqiptarë dhe të huaj, në edicione të posaçme.
12. Një vëmendje më e shtuar për trevat lindore shqiptare, të cilat do të jenë objekt i një projekti të madh të ITSHKSH-së, ku logjistika shkencore e profesionale e qendrave albanologjike në Tiranë dhe Prishtinë do të ishte dobiprurëse.

Për realizimin e objektivave të mësipërme do të parashikohet stafi akademik, i cili do të përzgjidhet në përputhje me veprimtaritë që parashikon zbatimi i kësaj marrëveshjeje.

Neni 2

Në qoftë se, nga bashkëpunimi ndërmjet këtyre institucioneve lind nevoja për menaxhim dhe mbulim të fondeve financiare, të nevojshme për realizimin e projekteve, institucionet do të lidhin marrëveshje të veçanta, sipas rastit.

Neni 3

Institucionet, në bazë të mundësive, të mjeteve në dispozicion dhe potencialit akademik, do të aplikojnë në organizma dhe institucione të tjera për realizimin e projekteve të përbashkëta.

Neni 4

Ky bashkëpunim mund të vazhdojë edhe pas afatit të përcaktuar më sipër, në qoftë se nuk ka kundërshtim nga palët.

Neni 5

Marrëveshja mund të ndryshohet apo të plotësohet me mirëkuptimin e të dyja palëve.

Ndryshimi apo plotësimi i kësaj marrëveshje bëhet me një marrëveshje aneks apo shtojcë, që do të jetë pjesë përbërëse e marrëveshjes bazë.

Neni 6

Palët e nënshkruajnë marrëveshjen, të motivuar nga parimet e shkëmbimit reciprok dhe bashkëpunimit të ndërsjellë, duke pasur parasysh mirëkuptimin dhe respektin e përbashkët.

Neni 7

Marrëveshja nënshkruhet në tri kopje, nga një kopje për tri palët.

AKADEMIA E STUDIMEVE
ALBANOLOGJIKE
TIRANË

INSTITUTI
ALBANOLOGJIK
PRISHTINË

INSTITUTI I TRASHËGIMISË
SHPIRTËRORE E
KULTURORE TË
SHQIPTARËVE - SHKUP

REKTOR


DREJTOR

DREJTOR

Prof. Dr. Luan PËRZHITA

Prof. Dr. Hysen MATOSHI

Prof. Dr. Skender ASANI



Marrëveshja nënshkruhet më datë 16.12.2021